



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Shëndetësisë**  
**Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health**  
**Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

Nr.:544/V/2020

Datë:27.05.2020

Në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë për bazë nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës; nenin 12 paragrafi 1.11 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi; nenin 8, paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 10 paragrafi 1 të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (19.02.2020); nenet 3, 4, 41, 44, 47 dhe 53 të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; nenet 44, 46 dhe 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; dhe nenin 27 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative; në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020, si dhe në përputhje të plotë me Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese nr. KO54/20 dhe KO61/20, Ministri në detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë, nxjerr:

**V E N D I M**

**për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19  
në territorin e Komunës së Gllgocit**

- I. Prej datës 28 Maj 2020 nga ora 21:00 e mbrëmjes deri në 05:00 të mëngjesit ndalohet qarkullimi i personave fizik jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunën e Gllgocit, përveç rasteve në vijim:**
- (a) Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor.
  - (b) Lejohet qarkullimi për personat fizikë në raste ku dalja nga shtëpia/banesa është e domosdoshme për t'u kujdesur për një ose më shumë të sëmurë, ose për një ose më shumë persona me aftësi të kufizuara, **vetëm nëse të sëmurët apo personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten;**
  - (c) Ndalimi i qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre nuk zbatohet në raste të viktimave të dhunës familjare. Viktimave të dhunës familjare u lejohet të dalin nga shtëpitë/banesat e tyre për të kërkuar strehim në një lokacion alternativ.
  - (d) Në raste të vdekjes, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të marrë pjesë në varrim, **por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit.**

- (e) Lejohet dalja nga shtëpia/banesa me kafshët shtëpiake jashtë orarit të lejuar të daljes, për nevojat fiziologjike të këtyre kafshëve, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia. Nuk lejohet shfrytëzimi i këtyre rasteve për të kryer ndonjë punë tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar.

## II. Gjatë qarkullimit të lëvizjes personat fizikë obligohen:

- (a) të mbajnë të mbuluara vetëm gojën dhe hundën, përmes maskës, shallit, apo ndonjë mbulese tjetër;
- (b) në çdo kohë, të ruajnë distancë prej dy metrash nga persona të tjerë.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një Vendim tjetër. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet çdo dispozitë e mëparshme që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Vendimi.

IV. Ky vendim do të rishqyrtohet në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ekspertët dhe ministrinë e tjera të linjës, për të vlerësuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e masave të përcaktuara, si dhe për të vendosur për vazhdimin ose jo të masave përkatëse.

V. Ministri i Shëndetësisë do ta ri-analizojë situatën epidemiologjike çdo ditë dhe në lidhje me secilën pikë të lartcekur dhe, pas konsultave paraprake, mund të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara.

## A r s y e t i m

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik të reduktuar krahasuar me situatën paraprake, e konstatuar nga IKShPK dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, dhe me qëllim të hapjes rrugë të rimëkëmbjes ekonomike në vend, Ministria e Shëndetësisë bazuar në kompetencat e saja të përcaktuara në Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Arben Vitia

Ministër në detyrë i Shëndetësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Zëvendësministrave;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
- Sekretarit të Përgjithshëm MSh,
- Departamentit Ligjor MSh,
- IKSHPK-së;
- Kryetarit/es të Komunës Glllogocit;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit sanitar;

- *Qendrës operative emergjente në MSh;*
- *Arkivit të MSh.*